



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**  
**TIRANE**

---

Nr. ..akti  
Dt.Regj.12.06.2020

Tiranë më, dt.02.07.2020

**V E N D I M**

**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga,

**GJYQTARE – VJOLLCA SPAHIU**

asistuar prej sekretares gjyqësore **Znj.Elenita Myftari**, sot më datë **02/07/2020**,mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, kërkesën penale me nr.1110 akti, me ;

**KERKUESE** : E... H., i biri Z..dhe N., i dtl.21.05.19.., lindur ne Bajram Curr dhe banues Tirane, Laprake, ....., i martuar me kater femije, arsimi i larte ne vazhdim, i vetpuenuar, i pa denuar, me shtetesi dhe kombesi shqiptare, (ne mungese), perfaqëesuar me deklarim nga avokati **Mirash Martini** me nr.1239 license dhe nipt K 31418042 A antar i dhomes se avokatise Tirane.

**OBJEKTI** : Ankim ndaj vendimit të sekuestros.

**BAZA LIGJORE**: Neni 212 të K.Pr.Penale.

Gjykata pasi çeli seancën gjyqësore të datës 02 korrik 2020 ;

**V Ë R E N**

Se, nga kërkuesi E.. H...është paraqitur kërkesa me objekt nga “Ankim ndaj sekuestros”, parashikuar, nga Neni 212 i K.Pr.Penale.

Pas ardhjes së kërkesës për gjykim Gjykata njoftoi palët në adresat përkatëse.

Në seancën gjyqesore të zhvilluar në dt.02.07.2020, Gjykata u bë me dije nga kërkuesi dhe përfaqësuesi i tij se pasi u njohen me ligjin për perfitimin nga kjo e drejte kërkojnë pushimin e gjykimit, kërkesë kjo e depozituar me shkrim.

Gjykata vëren se, kërkesa penale e Perfitim nga “Ankim ndaj vendimit të sekuestros”, parashikuar nga Neni 212 i K.Pr.Penal është një kërkesë e cila ngrihet me iniciativën e palës kërkuese.

Nëse nuk ekziston kjo kërkesë, Gjykata nuk mund të investohet ose, nëse hiqet dorë nga kërkesa para ose, gjatë gjykimit, ose kërkuesi nuk paraqitet në gjykim pa shkaqe të arsyeshme për të ndjekur çështjen, gjykimi nuk mund të vazhdojë.

Sa më sipër Gjykata, në vështrim të nenit parashikuar nga Neni 212 e 471/5 i K.Pr.Penale, çmon se gjykimi i kërkesës së kërkuesit E... H.. duhet mospranuar, sepse kërkuesi hoqi dorë nga kërkesa.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata, bazuar në neni 212 dhe 471/5 e vijues i K.Pr.Penal

### **VENDOSI**

- 1.Mospranimin e kërkesës penale nr.1110akti e dt.12.06.2020 me kërkues E.. H.., me objekt “Ankim ndaj vendimit të sekuestrimit”, parashikuar nga neni 212 të K.Pr.Penale.
- 2.Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- 3.Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

**U shpall sot në Tiranë me dt.02.07.2020.**

**SEKRETARE**

**ELENITA MYFTARI**

**GJYQTARE**

**VJOLLCA SPAHIU**

Shpenzime gjyqesore

Flet thirrje 150 (njeqindpesedhjet) leke